



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	05-09-2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ/Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHUK	5136/2022		1/1



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.679/2022

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, më Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.679/2022 të datës 01.08.2022 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ nga \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_

kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme-Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve publikë, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.09.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

*Refuzohet si e pabazuar* ankesa me numër A.nr.679/2022 e datës 01.08.2022, e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

**A r s y e t i m**

Ankuesi \_\_\_\_\_ më datë 01.08.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4449/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit të datës 26.07.2022 të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për refuzimin e aplikacionit për pozitën "Sekretar i Përgjithshëm 1" në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 08.08.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë. Ndërsa, Këshilli më datë 12.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër A.nr.679/2022 e datës 01.08.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesë për Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë nga ankuesi; Vërtetimin me numër Ref:4/4-65 i datës 22.11.2021



i lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Vërtetimin me numër Ref:4/4-55 i datës 25.07.2022 i lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Vërtetimin e datës 22.07.2022 nga Instituti Shqiptar për Gjeopolitikë; Vërtetimin me numër protokollit 176 i datës 25.02.2022 i lëshuar nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike; Letër Motivuese e datës 07.07.2022, 24.11.2021 e ankuesit; Akt Emërimit e datës 21.02.2019, 26.04.2016, 06.05.2011 për ankuesin; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës për vitin 2020 i datës 16.12.2019; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 28.01.2022; Kontrate punë për kohë të caktuar me Nr. 415.1 nga Kolegji Universum; Vendimin e datës 30.01.2015 për avancim në pozitë Zyrtar i Lartë për Sigurimin e Cilësisë; Kontratë e Marrëdhënies së punës me numër të kontratës 04/2010 e datës 01.02.2010; Kontratë e Marrëdhënies së punës me numër të kontratës 01/2008 e datës 01.03.2008; Kontratë e Marrëdhënies së punës me numër të kontratës 01/2006 e datës 01.04.2006; Certifikatë e datës 27.04.2011; Certifikatë e datës 21.06-23.07.2010; Certifikatë e datës 02-27.07.2007; Certifikatë e datës 26.05.2006; Certifikatë e datës 03.11-26.12.2008; Certifikatë qershor 2022, maj 2022; Certifikatë e datës 17.01.2021-11.02.2011; Certifikatë e datës 29.07.2009; Certifikatë e datës 26-27.02.2014; Diplomën me Nr.825/1216; Certifikatën nga Gjykata Themelore në Prishtinë e datës 13.07.2022; Diplomën me Nr. 966 e datës 10.03.2011; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 08.08.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 12.08.2022; Konkursin me Nr. Reference RN00009212 i datës 10.06.2022 për Sekretar të Përgjithshëm 1; Vendimin me Nr. 04/73 i datës 30.04.2022 për emërimin e Komisionit Shtetëror të Pranimit; Lista e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar; Njoftimin e datës 21.07.2022 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë për listë të ngushtë; Emailin e datës 21.07.2022 për ankuesin; Njoftimin përmes emailit të datës 26.07.2022 për ankuesin; Emailin e datës 25.07.2022 , 21.07.2022, 23.07.2022 nga ankuesi; Aplikacionin e ankuesit me dokumentet e bashkangjitura.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi ***është e pa bazuar ankesa e ankuesit, sepse:***

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton së njësia përgjegjëse përkatësisht Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 10.06.2022 ka shpallur Konkursin me numër reference RN00009212, për pozitën Sekretar i Përgjithshëm 1 në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, i hapur për aplikim nga data 10.07.2022 deri më datë 17.07.2022. Në këtë konkurs ka aplikuar dhe ankuesi i cili me datë 21.07.2022 është njoftuar nga njësia përgjegjëse së nuk ka plotësuar kushtet e konkursit konkretisht përvojën e punës prej pesë (5) vitesh në pozita drejtuese, ndërsa me kërkesë të ankuesit me datë 22.07.2022 është mbajtur edhe takimi sqarues lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankuesit, ku serish në sqarimin e datës 26.07.2022 të njësisë përgjegjëse ankuesi është njoftuar se është ri shqyrtuar dhe verifikuar në tërësi aplikacioni i tij, por që nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshëm të përvojës së punës prej pesë (5) vite në pozita drejtuese, duke e udhëzuar që pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 8 ditësh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se ka plotësuar kushtet e konkursit rrjedhimisht Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë nuk ka vërtetuar drejtë dokumentacionin e dorëzuar. Propozon që Këshilli ta aprovoj ankesën dhe të detyroj DMZP-në që aplikacionin e ankuesit ta përfshij në

procedurën e mëtejme të rekrutimit për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Sipas shpalljes së Konkursit me numër reference RN00009212 për pozitën Sekretar i Përgjithshëm 1 në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, si kushte të përgjithshme formale, janë përcaktuar: **Arsimi:** diplomë universitare me të paktën 240 kredi/ECTS-së apo ekuivalente me të e preferuar në fushat që ndërlidhen me fushëveprimin e institucionit kur rekrutohet. **Përvoja e punës:** së paku (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë pune në pozita drejtuese.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimit ankimor të ankuesit së i njëjti ka plotësuar kushtet e konkursit në fjalë, Kolegji ka analizuar dokumentacionin e aplikimit të ankuesit dhe si rrjedhojë ka gjetur se i njëjti lidhur me kriterin e arsimit posedon: Diplomë me Nr.966 të datës 10.03.2011 të lëshuar nga Fakulteti i Filologjisë i Universitetit të Prishtinës, për përfundimin e studimit themelore në drejtimin e orientalistikën duke marr titullin Baçelor i Orientalistikës me 180 pikë Diplomë me Nr.825/1216 të datës 06.12.2016 të lëshuar nga Kolegji Fama për përfundimin e studimeve Master i Arteve në Administratë Publike. Ndërsa lidhur me përvojën e punës ankuesi posedon: Vërtetimin me numër protokolli 176 të datës 25.02.2022 të lëshuar nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike më të cilin dëshmohet së i njëjti ka punuar në këtë institucion fillimisht nga data 10.04.2006 deri më datë 01.03.2008 në pozitën Roje Sigurim, nga data 01.03.2008 deri më datë 01.02.2010 në pozitën e punës Udhëheqës i Ndërrimit të Rojeve, ndërsa nga data 01.02.2010 deri më datë 01.02.2015 në pozitën Zyrtar i Vlerësimit; Vërtetimin me numër Ref:4/4-55 të datës 25.07.2022 të lëshuar nga Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit më të cilin vërtetohet së ankuesi është i punësuar në këtë ministri dhe atë si vijon: nga data 02.07.2015 deri më datë 01.08.2015 ka ushtruar pozitën e Zyrtarit për Trajnim të Mësimdhënësve, nga data 01.08.2015 deri më datë 16.02.2017 ka ushtruar pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Arsim Privat Parauniversitar, nga data 16.02.2017 deri më datë 02.08.2017 ka ushtruar pozitën e Zyrtarit për Trajnimin e Mësimdhënësve, nga data 02.08.2017 deri më datë 21.02.2019 ka ushtruar pozitën e Zyrtarit për Arsim Profesional-drejtime teknike dhe prej datës 21.02.2019 ku dhe vazhdon ta ushtroj pozitën e Zyrtarit të Lartë për Arsim Profesional drejtime teknike; Vërtetimin e datës 22.07.2022 të lëshuar nga Instituti Shqiptar për Gjeopolitik, më të cilin ankuesi punon në pozitën Sekretar Shkencor nga data 10.06.2021, Vërtetimin me Nr.8115/1 të datës 25.07.2022 të lëshuar nga Kolegji Universum ankuesi nga data 01.10.2017 punon në pozitën Ligjërues dhe Drejtor i Departamentit të Administratës Publike.

Andaj, bazuar në dëshmitë e administruara Kolegji vlerëson së ankuesi nuk ka plotësuar kriterin e përvojës së punës respektivisht të përvojës drejtuese pesë vjeçare, pasi që sipas vlerësimit të Kolegjit përvoja udhëheqëse në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike për periudhën kohore nga data 01.03.2008 deri më datë 01.02.2010 ka të bëjë më periudhën para diplomimit të ankuesit, kështu që duke u bazuar edhe në Aktgjykimin A.nr.2276/2014 të datës 24.05.201, A.nr.729/16 të datës 04.05.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykimin AA.nr.367/1819.12.2018 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin ARJ-UZVP.nr.77/2019 të Gjykatës Supreme të Kosovës, përvojë e punës profesionale duke përfshirë edhe atë drejtuese njihet vetëm periudha pas diplomimit, ndërsa përkitazi me përvojën e punës drejtuese në Kolegjin "Universum" në pozitën Drejtor i Departamenti të Administratës Publike nga data 01.08.2017 deri tani, Kolegji ka gjetur së ankuesi



posedon Kontratë Punë për Kohë të Caktuar e cila është lëshuar me datë 01.08.2017 me Nr.415/1 mirëpo e njëjta është e nënshkruar vetëm nga punëdhënësi gjegjësisht nga Drejtori Ekzekutiv e jo nga ankuesi dhe së lidhur me këtë përvojë pune nuk ka ofruar dëshmi shtesë qoftë nga vet punëdhënësi siç është vërtetimi i punës apo edhe nga organet tjera kompetente për pagesë të kontributeve dhe detyrimeve ligjore, kështu që, duke marr parasysh këto rrethana Kontrata e Punës për Kohë të Caktuar me Nr.415/1 e lëshuar me datë 01.08.2017, nuk konsiderohet dokument i mjaftueshëm për të provuar përvojën drejtuese pranë Kolegjit Universum, andaj bazuar në arsyet si me lartë e njëjta nuk mund të cilësohet edhe si akt i vlefshëm në kuptim të nenin 10 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, me të cilin është përcaktuar se : *Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuar...* Nisur nga këto konstatime rrjedh së ankuesi nuk ka plotësuar kriterin e përvojës drejtuese siç është përcaktuar me Konkursin me numër reference RN00009212, rrjedhimisht mbi këtë bazë pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Mbi bazën e konstatimeve si me lart, Kolegji i Këshillit vlerëson që Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me rastin e mos përfshirjes së ankuesit në listën e ngushtë në procedurën e rekrutimit sipas Konkursit me numër reference RN00009212 për pozitën Sekretar i Përgjithshëm 1 në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë dispozitat materiale duke vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafi 5 nën paragrafi 5.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 8 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, i cili përcakton se: 2. *Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikacionit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak.* 3. *Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë konkurrimin në fazën e vlerësimit profesional.*

Andaj theksuar si me sipër, Kolegji duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente/ Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

#### KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.679/2022

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



#### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.